



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:114033
Datë: 30.03.2024
Numri i dokumentit: 05528881

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses E.D., nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ilri Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar Q.B-H., për kompensimin e shujtave ditore, vlera e kontestit 502.00 euro, jashtë seance me datë 29.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses E.D., nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësjat të lartcekur, në emër të kompensimit të shpenzimeve shujtave ditore, për periudhën kohore nga 01.09.2020 e deri me datë 30.12.2021, respektivisht për 247 ditë të pranisë në punë, të ia paguajë shumën prej 494.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 18.04.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses për periudhën kohore nga data 05.12.2019 e deri me datën 01.09.2020 dhe kërkesa përtej shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit dhe atë në lartësi prej 8.00 euro.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124.00.-€ (njëqind e njëzet e katër euro), në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësja, në këtë gjykatë me datë 18.04.2023 përmes të autorizuarit të saj Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shujtave ditore, duke theksuar se i njëjti është e punësuar si mësimdhënëse në shkollën “...” në Gjakovë ku nga data 29.11.2019 deri me datë 31.12.2021 ka realizuar 247 ditë pune, provuar sipas vërtetimit numër 01/873. Të njëjtës nuk i është kompensuar nga e paditura obligimi për ushqimin në punë, andaj ka paraqitur padi ku ka kërkuar nga gjykata që të detyrojë të paditurën që të bëjë pagesën e kompensimit për shujta për 321 ditë në shumë prej 502.00 euro, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj Q.B-H., në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 11.03.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se paditësjat nuk i takon ky kompensim sepse nuk është përcaktuar me kontratën e punës, e as me Ligjin e Punës numër 03/L-212, prandaj kërkesës së paditësjat iu mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësja nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Sipas kontratave të punës parashihet për mësimdhënës që të i kenë 20 orë në javë si orë pune dhe 20 orë në javë si orë mësimi, e që të njëjtit nuk i përmbahen këtij orari. Tutje ka cituar dispozitën e nenit 46 par.2 të KKAK-së ku shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, për çka ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet e parapara në Kontratë sepse të paditurës nuk i janë ndarë mjetet financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive për pagesën e shujtës. Po ashtu e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditësjat ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në

përfundim se kërkesëpadia e paditësjat është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se paditësja është në mardhënie pune të e paditura, përkatësisht në shkollën “...” në Gjakovë dhe e njëjta në periudhën prej datës 01.09.2020 e deri me datë 31.12.2021 ka punuar gjithsej 247 ditë pune, fakt i vërtetuar përmes Vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me numër 01/873 e lëshuar nga Drejtoresha e shkollës, me datë 29.11.2022. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditësja nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me nenin 35 par.7 të KKAK, ku është përcaktuar se *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim për t’ a bërë kompensimin”*. Në rastin konkret, gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësja është e bazuar vetëm sa i përket periudhës kohore nga data 01.09.2020 deri me datë 31.12.2021 ashtu që bazuar në Vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja gjatë kësaj periudhe kohore ka vijuar gjithsej 247 ditë, ashtu që gjykata pasi bëri përllogaritjen në atë mënyrë që ditët e pranisë në punë i ka shumëzuar me 2, ia njohi shumën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për shujta, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiisë rrjedh nga Kontrata

Kolektive e Arsimit, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se *“Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”* Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës numër 03/L-212 ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Andaj, për këtë arsye, gjykata konsideron se edhe pse Ligji i Punës specifikisht nuk e ka përcaktuar kompensimin për shujta, një gjë të tillë e ka paraparë Kontrata Kolektive e Arsimit, si marrëveshje kolektive në përputhje me Ligjin e Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësja dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësja.

Gjykata analizoi edhe pretendimet e tjera të përfaqësueses ligjore të të paditurës dhe atë në lidhje me faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative për realizimin e kërkesës, mirëpo një pretendim të tillë e refuzoi pasi që gjykata nuk është e lidhur me mjetet administrative brenda institucionit përkatës kur vendos lidhur me kërkesën. Në rastin konkret, për të paditurën detyrimi për të kompensuar kompensimin në emër të ushqimit rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit dhe nuk duhet të jetë e lidhur me kërkesën e të punësuarit. Rrjedhimisht paditësja, si e punësuar në arsim, nuk ka qenë e detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim të shujtave, pasi të njëjtën punëdhënësi do të duhej të ia përmbushte në momentin që janë plotësuar kushtet për kompensimin e saj në përputhje me kontratën kolektive të lartcekur, prandaj meqë një detyrim i tillë nuk është përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç kanë vepruar në rastin konkret paditësja.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pikës I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadi, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadi”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadi është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadi qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësja, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Sa i përket pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadi, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadi”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadi është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadi qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësja, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*. Kjo pasi që pretendimet e të autorizuarës së të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, i morri pjesërisht të bazuara pasi që sipas provave të administruara vërtetohet se paditësja kërkesën e saj për kompensimin në emër të ushqimit në punë për periudhën kohore të kërkuar prej datës 05.12.2019 deri me datë 18.04.2020 e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, kjo pasi që paditësja ka parashkruar padi me datën 18.04.2023, pra pas kalimit të afatit prej tre vjetësh për këtë periudhë. Ndërsa pas datës 18.04.2020 e deri me datën 01.09.2020, paditësja nuk ka ofruar prova për ditët e pranisë në punë për këtë periudhë, e poshtu nuk ka ofruar prova as edhe për 4 ditë të pranisë në punë, pasi që nga vërtetimi mbi dëshminë ditëve të pranisë në punë shihet se paditësja ka realizuar 247 ditë të pranisë në punë dhe jo 251 siç e ka pretenduar paditësja. Paraqitja e prova mbi të cilën i mbështet faktet sipas nenit 7 të LPK-së ka qene detyrim ligjor i paditëses. Nga kjo rrjedh padia e paditëses ka mbështetje në prova vetëm sipas kërkesës për të cilin edhe është vendosur në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç' rast paditësja iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

- Departamenti i Përgjithshëm -

C.nr. 2023:030494, datë 29.03.2024

Gj y q t a r j a,
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.